VENDIM
Nr. 36, datë 3.7.2024

PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN "PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT QENDROR TË REGJISTRIMIT DHE SHLYERJES SË TITUJVE (AFISAR)"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 76, datë 18.12.2014, i ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në nenin 50, pika 5/1, shkronja "a", ndryshon sipas përmbajtjes: "*Operacionet e veçanta shlyhen në bazë mujore, në ditën e parë të muajit pasardhës"*.

2. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me botimin e këtij vendimi përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko